



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 6 paragrafi 4, nenit 7 paragrafi 1, nënparagrafi 1.31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, si dhe në pajtim me Ligjin Nr. 03/L - 54 për Vulat në Institucionet e Republikës së Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 21 tetor 2022, miratoi këtë:

Udhëzim Administrativ Nr. 01/ 2022 për Vulat dhe Simbolet në Sistemin Prokurorial të Republikës së Kosovës

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i formës dhe përmbajtjes së vulës, përdorimi i simboleve, ruajtja dhe përgjegjësia e përdorimit të tyre në sistemin prokurorial të Republikës së Kosovës.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ zbatohen nga të gjithë zyrtarët e sistemit prokurorial.

Neni 3
Përkufizimet

Sistemi prokurorial - nënkupton Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorin e Shtetit;

Komisioni - nënkupton Komisionin e emëruar nga zyrtari më i lartë administrativ, i cili zhvillon procedurat për marrjen e lejes për vulë, porositjen e vulave të vulëpunuesi, mbikëqyrjen, arkivimin e tyre dhe veprimet e tjera, të parapara me Ligjin nr. 03/L - 54 për Vulat në Institucionet e Republikës së Kosovës.

Neni 4
Forma dhe madhësia e vulës në sistemin prokurorial

1. Vula ka këtë formë dhe madhësi:
 - 1.1. Vula ka formë rrethore.
 - 1.2. Madhësia e vulës është me diametër prej 40 mm, 50 mm dhe 60 mm.
2. Madhësia e vulës përcaktohet sipas gjatësisë së tekstit dhe numrit të gjuhëve, të cilat duhet t'i përmbajë vula.
3. Vula ka rrathë koncentrikë dhe përmban këto të dhëna:
 - 3.1. Në rrethin e parë të jashtëm shkruhet: Republika e Kosovës;
 - 3.2. Në rrethin tjetër shkruhet emri dhe selia;
 - 3.3. Në sipërfaqen e mbetur brenda rrethit vendoset Stema e Republikës së Kosovës.
4. Teksti i vulës së Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit shkruhet me shkronja të mëdha të shtypit në gjuhët zyrtare të Republikës Kosovës.
5. Lejohet që të ketë më shumë ekzemplarë të vulës, nëse ushtrohet veprimtaria në shumë së në një ndërtesë dhe nëse kjo është e domosdoshme në harmoni me kërkesat e punës.
6. Nëse ka më shumë ekzemplarë të vulës, atëherë, secili ekzemplar shënohet me numrin rendor romak, i cili vihet në mes.

Neni 5
Vula katrore

1. Vulat katrore të sistemit prokurorial përdoren për protokollimin e shkresave.
2. Si rregull, vula katrore ka dimensiononin 35 mm me 70 mm, sipas nevojës mund të ketë edhe dimensione të tjera, ashtu që të ketë vend për gjuhë zyrtare të Republikës së Kosovës.
3. Teksti i vulës katrore shkruhen në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Madhësia e vulës katrore përcaktohet sipas gjatësisë së tekstit, të cilën duhet ta përmbajë vula.

Neni 6

Përmbajtja e vulës katrore

1. Vula katrore përmban këto të dhëna sipas renditjes:
 - 1.1. Në të majtë, shikuar përpara, vendoset Stema e Republikës së Kosovës, kurse në të djathtë Stema e Këshillit Prokurorial të Kosovës ose Prokurorit të Shtetit.
 - 1.2. Republika e Kosovës;
 - 1.3. Emërtimi i institucionin i shkruar me shkronja të mëdha të shtypit;
 - 1.4. Emërtimi i njësisë organizative të institucionit;
 - 1.5. Numri i protokollit të njësisë organizative;
 - 1.6. Hapësira ku do të shënohet numri i faqeve;
 - 1.7. Hapësira ku do të shënohet data, muaji dhe viti;
 - 1.8. Vendi i selisë së institucionit.
2. Prokurori i Shtetit ka edhe vulën elektronike për protokollimin e shkresave.
3. Vula konfidenciale përdoret për të vulosur dokumentet konfindeciale, ka formën katrore, ngjyrë të kuqe dhe me shkrimin confidential në mes.
4. Vula sekrete, e cila përdoret për të vulosur dokumentet top secret ka formën katrore, ngjyrë të kuqe dhe me shkrimin top secret në mes.

Neni 7

Përdorimi i vulës

1. Vula shërben për të vërtetuar aktin autentik zyrtar, të cilin e lëshon institucioni.
2. Me vulë vulosen vetëm ato akte, dokumente dhe shkresa, që janë nënshkruar nga personi i autorizuar.
3. Vula vihet në anën e majtë të nënshkrimit të personit, në mënyrë që do të mbulojë, afërsisht, një të katërtën (1/4) e nënshkrimit.

4. Personi përgjegjës që përdor vulën është përgjegjës për autorësinë dhe vërtetësinë e dokumenteve, në të cilat vihet vula.
5. Për çdo përdorim të vulës, personi përgjegjës është i detyruar të mbajë evidencë për vulat që i ka në përdorim.

Neni 8 Simbolet

1. Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit ka simbolet e veta unike.
2. Simbolet e Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit janë: flamuri, stema dhe logoja.
3. Me flamurin, stemën dhe logon përkatëse përfaqësohet Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit.

Neni 9 Flamuri

Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit kanë flamujt e vetë unikë.

Neni 10 Përdorimi i flamurit të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit

1. Flamuri i Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit vendoset në mjediset e brendshme dhe të jashtme. Në mjedisin e brendshme vendosen:
 - 1.1. Në sallën e takimeve të Këshillit;
 - 1.2. Në Zyrën e Kryesuesit të Këshillit;
 - 1.3. Në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, dhe
 - 1.4. Në zyrat e kryeprokurorëve.
2. Në mjedisin e jashtme vendoset:
 - 2.1. Në të gjitha objektet e sistemit prokurorial, para hyrjes së objektit, në vendin e

veçantë për flamuj.

3. Flamuri i Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit përdoret në rastet e takimeve ceremoniale të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore me përfaqësues të shteteve të huaja, konferenca vjetore dhe konferenca për media.

Neni 11 Stema

Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit përdorin Stemën e Republikës së Kosovës.

Neni 12 Logot

1. Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit kanë logot e veta unike.
2. Logot e Këshillit Prokurorial i Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit përdoren si shenjë identifikimi.
3. Logot e Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit vendoset:
 - 3.1. Në hyrje të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit;
 - 3.2. Në të gjitha aktet zyrtare;
 - 3.3. Në vulat, dhe
 - 3.4. Në të gjitha dokumentet dhe marrëveshjet ndërinstitucionale.

Neni 13 Komisioni

1. Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së emëron me vendim komisionin prej tre anëtarësh, i cili bën porositjen e vulës te vulëpunuesi.
2. Vula punohet nga vulëpunuesi, i cili e ka të regjistruar veprimtarinë e tij, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi për regjistrimin e bizneseve.

3. Komisioni mbikëqyrë punën e vulëpunuesit, e shpallë të pavlefshme vulën dhe arkivimin e vulës.
4. Lidhur me arkivimin e vulës, komisioni përpilon procesverbalin në tri kopje identike, ndërsa një kopje e mban në arkivin e institucionit.
5. Pas pranimit të vulës nga komisioni, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, nxjerr vendim për datën e fillim të përdorimit të vulës.
6. Komisioni obligohet që pas përfundimit të punës nga vulëpunuesi, të kërkojë nën mbikëqyrje e tij t'i asgjësojë të gjitha modelet, kallëpet dhe të gjitha gjurmët e tjera, të cilat kanë mbetur gjatë procesit të punimit të vulës nga vulëpunuesi. Pas përfundimit të procesit të asgjësimit, komisioni mban procesverbalin, të cilën e nënshkruan edhe vulëpunuesit, përveç anëtarëve të komisionit.
7. Për çdo veprim, Komisioni harton procesverbal.
8. Mandati i komisionit është deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Prishtinë, 21.10.2022

Jetish Maloku

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

